



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.187, datë 12.07.2022

PËR

“SHPALLJEN E VENDEVE TË LIRA PËR MAGJISTRATËT E EMËRUAR NË
VITIN 2022”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 39 pika 1 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenet 164 pika 8 dhe 189 pika 1 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë 22 (njëzetë e dy) vende të lira për caktimin e të emëruarve nga radhët e magjistratëve të rinj të diplomuar në vitin 2022, si më poshtë:

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës - 2 vende;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë - 1 vend;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër - 4 vende;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër - 2 vende;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin - 1 vend;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë - 1 vend;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje - 1 vend;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat - 1 vend;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë - 3 vende;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec - 1 vend;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër - 2 vende;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë - 2 vende;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë - 1 vend.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

3. U shpall në Tiranë, sot më 12.07.2022.

